STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 5 gusht 2013

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON ZGJATJEN E STREHIMIT PER VIKTIMAT E SENDIT (SANDY)

Programi i Ndihmës për Strehimin e Përkohëshëm zgjatet në dy faza

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se Agjencia e Administrimit të Ndihmës Federale (Federal Emergency Management Agency) (FEMA), me kërkesë të Shtetit të Nju Jorkut (State of New York), ka miratuar një zgjatje në dy faza të programit të Ndihmës për Strehimin e Përkohëshëm (TSA).

FEMA do të vazhdojë të analizojë 84 familjet e mbetura që përdorin ende programin TSA dhe zgjatja e re do të përfshijë fazën e parë deri më 16 gusht dhe të dytën deri më 1 shtator. Zgjatja u lejon të mbijetuarve të super stuhisë Sendi (Sandy) që kualifikohen, të cilët nuk mund të kthehen në shtëpitë e tyre, të qëndrojnë në hotelet ose motelet që marrin pjesë në këtë program.

"Programit i Ndihmës për Strehimin e Përkohëshëm vazhdon të jetë një burim i rëndësishëm për viktimat e super stuhisë Sendi (Sandy)," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Zgjatja e këtij programi është gjëja e drejtë për t'u bërë për pronarët e shtëpive të zhvendosur që vazhdojnë të kërkojnë plane të strehimit të qëndrueshëm për të ardhmen."

Ky është një progam afat-shkurtër që vendos familje në hotele ndërsa punojnë drejt një plani të strehimit me afat më të gjatë.

Për t'u kualifikuar për TSA, të mbijetuarit fillimisht duhet të bëjnë kërkesë për ndihmë federale nëpërmjet FEMA duke:

- U rregjistruar në internet në www.DisasterAssistance.gov;
- U rregjistruar nëpërmjet telefonave të zgjuar ose kompjuterave portative duke përdorur aplikacionin e FEMA ose duke shkuar tek m.fema.gov; ose
- U rregjistruar duke telefonuar në 800-621-FEMA (3362) (TTY 800-462-7585). Për 711 ose Shërbimin e Stafetës Video (VRS), telefononi në 800-621-3362.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418